

KONGRESI

Kongresi është organi më i lartë i BSPSH dhe normalisht mbledhet çdo 5 vjet. Të drejtën për të shpallur thirrjen e kongresit të radhës e ka Asambleja Kombëtare e BSPSH-së, e cila shpall atë jo më vonë se dy muaj para mbajtjes së tij.

Kongresi i BSPSH-së shpall fillimin e punimeve me pjesëmarrjen e 2/3 të delegatëve të vërtetuar nga komisioni i mandateve.

DETYRAT

1. Kongresi i BSPSH analizon veprimtarinë e BSPSH për periudhën përkatëse, gjendjen dhe zhvillimin e strukturave përbërëse të saj, situatën social – ekonomike e politike të vendit, përcakton platformën dhe politikat prioritare dhe jep orientimet themelore për katër vitet e ardhshme.

2. Zgjedh Presidentin e BSPSH.
3. Miraton strukturën përbërëse të Asamblesë Kombëtare të BSPSH-së.
4. Miraton Komisionin e Interpretimit dhe Zbatimit të statutit.
5. Miraton Komisionin e Kontroll Revizionit.
6. Miraton ndryshimet e Statutit të BSPSH-së.
7. Shpall kur e sheh të pashmangshme shpërbërjen e BSPSH-së.